



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 214, Datë 30/1/2016

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", mori në shqyrtim ankesën nr. 21, datë 17.02.2016, e znj. [i] [i], ku pretendohet diskriminim për shkak të bindjeve politike, nga ana e Ujësjiellës Kanalizime Tiranë SHA.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Znj. [i] [i] ka punuar në pozicionin e arkëtares në Zyrën e Marrëdhënieve me Konsumatorin¹, në Sektorin e Arkëtimit, Dega e Arkëttimeve të ndërmarjes Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë SHA (UKT SHA)², që prej datës 31.05.2012. Sipas shpjegimeve të dhëna prej saj, me Vendim nr. 938, datë 24.12.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm, ankueses i është dhënë masa disiplinore "vërejtje me shkrim", për shkak të mosrespektimit të Rregullores së Brendshme të UKT-së, si dhe për moszbatim të detyrave funksionale. Në vijim, nëpërmjet Vendimit nr. 1038, datë 28.12.2015, znj. [i] [i] kalon në pozicionin "Teknike bilanci" dhe më pas, nëpërmjet Vendimit nr. 11, datë 05.01.2016, UKT SHA, ka vendosur zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të. Referuar vendimit të fundit, motivacioni i zgjidhjes së marrëdhënies së punës, ka qenë për shkak të shkurtimeve të vendit të punës, ndërkohë që znj. [i] [i] thekson faktin se realisht ajo është larguar nga puna për shkak të bindjeve të saj politike, të djathta, të cilat janë të ndryshme me bindjet politike të drejtuesit të shoqërisë. Ajo është anëtare e subjektit politik "Partia Demokratike e Shqipërisë"³; Vëzhguese e këtij subjekti në KZAZ qarku Elbasan në zgjedhjet e vitit 2009; Anëtare e KQV-së Nr. 2337 në zgjedhjet e vitit 2013; Anëtare e këtij subjekti pranë KZAZ Nr. 49 në Elbasan, gjatë zgjedhjeve për pushtetin lokal në vitin 2015.

¹ Zyra e Marrëdhënieve me Konsumatorin në "Rrugën e Durrësit"

² Ankuesja ka filluar punë pranë UKT Sh.a më datë 31.05.2012

³ Në cilësinë e provës është depozituar fotokopje e kartës së anëtarësimit, Nr.175306082V, datë 28.01.2016



Hapat proceduriale të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Pas analizimit të ankesës nr. 21, datë 17.02.2016, e znj. ..., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga nenin 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Për këtë arsye, Komisioneri filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj. Mbështetur në nenin⁴ 33, pika 7, të ligjit nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", me shkresë nr. 235/1, datë 19.02.2016, Komisioneri iu drejtua UKT SHA për informacion mbi çështjen e parashtruar nga ankuesja.

- Në përgjigje të së Komisionerit, UKT dërgoi shkresën nr. 842/1, datë 07.03.2016, ku sqarohet se ristrukturimi i UKT SHA është kryer në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Ortakëve dhe Vendimit të Këshillit Mbikqyrës, për shkak të gjendjes së rënduar financiare, në të cilën ndodhet shoqëria, si dhe për shkak se struktura e kësaj Shoqërie ka qenë e mbingarkuar.

- Sipas shkresës së mësipërme, ndërprerja e marrëdhënieve të punës për këtë punonjës është bërë në zbatim të nenit 148 të Kodit të Punës, për pushimet kolektive nga puna. Duke iu përmbajtur kërkesave të këtij neni, Shoqëria ka njoftuar Sindikatën e Pavarur të punonjësve të UKT SHA, për arsyet e pushimit kolektiv dhe pas konsultimeve të kryera me përfaqësuesit e kësaj sindikate, ndërmjet saj dhe UKT SHA është nënshkruar marrëveshja për pushimin kolektiv. E gjithë procedura e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit është kryer në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe si rrjedhim nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkak të bindjes politike të znj. Në shkresë theksohet fakti se largimi nga puna është bërë vetëm për arsye të ndryshimit të strukturës së Shoqërisë dhe përkatësisht për shkak të suprimimit të pozicionit të punës.

2. Në vijim të procedurave hetimore, në zbatim të Urdhërit nr. 54, datë 30.03.2016, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Për kryerjen e inspektimit pranë Ujësjiellës Kanalizme SHA", Inspektorë të Komisionerit bënë verifikimet përkatëse në lidhje me ankesën e z. Në këtë pikë sqarojmë se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka zhvilluar një proces hetimi pranë UKT-së, lidhur me një grup ankesash të paraqitura nga ish punonjës të këtij institucioni me pretendim diskriminim për shkak të bindjeve politike. Konkretisht Urdhri i sipërpërmendur i është referuar ankesave të paraqitura nga këta ankues:

- Inspektorët e KMD-së u takuan me znj. ..., Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, së cilës iu kërkua që t'i vihehin në dispozicion aktet lidhur me numri i punonjësve, që janë larguar nga puna, pranë Zyrës së Marrëdhënies me Konsumatorit (Rruga e Durrësit) si pasojë e zbatimit të strukturës së re organike të UKT SHA; Kopje të strukturës organike aktuale të UKT SHA/Zyra e Marrëdhënies me Konsumatorin; Kopje e strukturës organike të mëparshme të UKT SHA/Zyra e Marrëdhënies me Konsumatorin; Kriteret e marra në konsideratë nga punëdhënësi për kryerjen e shkurtimeve, në bazë të strukturës së re të UKT; Vlerësimet vjetore në punë të ankuesit; Informacion mbi punonjësit që janë emëruar në Zyrën e Marrëdhënies me Konsumatorit pas hyrjes në fuqi të strukturës organike aktuale të UKT SHA; Informacion mbi punonjësit që janë emëruar në Zyrën e Marrëdhënies me Konsumatorit në muajin dhjetor 2015.

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: "Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, t'u paraqesin parashtrimet me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër".

Znj. kërkoj disa ditë kohë për të kryer verifikimet dhe për të gjetur dokumentacionin, sipas përkrahimit në Urdhërin e Inspektimit. Për sa më sipër, u ra dakord që informacioni i kërkuar, të dërgohej në ditët në vijim, nëpërmjet shërbimit postar në adresë të Komisionerit.

- Me shkresën nr. 7132/1, datë 11.04.2016, UKT SHA dërgoi dokumentacionin e kërkuar nga ana e KMD-së, sipas kërkesave të përcaktuara në Urdhërin e inspektimit.

3. Në vijim të procedurave të mëtejshme, nëpërmjet shkresës nr. 235/2, datë 03.05.2016, palët u njoftuan për seancën dëgjimore për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre, e cila u zhvillua më datën 16.05.2016 në zyrat e Komisionerit. Në seancë u paraqit vetëm ankesja, ndërsa përfaqësuesit e UKT-së nuk u paraqitën dhe as nuk njoftuan mospjesëmarrjen e tyre.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara në ligjin nr.10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

I. Lidhur me trajtimin e pabarabartë, të pretenduar nga ankuesja,

Mbështetur në nenin 7 pika 1 e ligjit 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", parashikohet se: *"Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim".*

- Gjatë procedurave të shqyrtimit të ankesës, vërejmë se ankuesja ka filluar punë pranë ndërmarrjes UKT SHA, në maj 2012 në pozicionin "Arkëtare" në Sektorin e Arkëtimit, në Zyrën e Marrëdhënieve me Konsumatorin. Gjatë periudhës maj 2012-dhjetor 2015 nuk rezultoi që punëdhënësi UKT SHA të ketë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj ankueses.
- Më datën 24.12.2015, me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm, asaj i është dhënë masa disiplinore "vërejtje me shkrim", për shkak të mosrespektimit të Rregullores së Brendshme të UKT-së, si dhe për moszbatim të detyrave funksionale. Në vendim theksohet se "Masa disiplinore shuhet brenda 6 muajve". Sapo ka marrë masën disiplinore, vetëm 4 ditë më vonë, më datën 28.12.2015, me vendim nr. 1038 të Drejtorit të Përgjithshëm, znj. Balukja ka kaluar në pozicionin "Teknike bilanci", një pozicion promovues, në krahasim me pozicionin "Arëktare", që ankuesja mbante më parë.
- Disa ditë pas emërimit të ankueses në pozicionin "Teknike bilanci", UKT SHA më datën 05.01.2016, ka vendosur zgjidhjen e kontratës së punës, me pretendimin se "Për shkak ndryshimit të strukturës së Shoqërisë, pozicioni i punës, suprimohet".

Përsa më sipër, duke vlerësuar dinamikën e ngjarjeve; harkun kohorë të tyre dhe veprimet administrative të ndërmarra nga Drejtori i Përgjithshëm i UKT SHA, vërejmë se:

- Në dukje praktika e veprimeve të lë përshtypjen e një procesi të rregullt administrativ.

Duke analizuar më vete çdo veprim të ndërmarrë nga Drejtori i UKT, në veçanti duke iu referuar datave dhe afateve, vërejmë se:

- Vet institucioni në praktikën e vet është kontradiktor dhe për më tepër në shkelje të parashikimeve të bëra. Konkretisht akti “Vendim nr. 1038, datë 28.12.2015” i Drejtorit të Përgjithshëm për kalimin e ankueses në pozicionin “Teknike bilanci”, katër ditë pas marrjes së masës disiplinore, kur shuarja e masës vjen pas 6 muajve, është në shkelje të hapur dispozitave të parashikuara në Rregulloren e institucionit, lidhur me performancën e punonjësve.
- Në vazhden e shkeljeve së këtyre dispozitave, disa ditë më pas, më datën 05.01.2016, UKT SHA, ka vendosur zgjidhjen e kontratës së punës, me ankuesen me pretendimin “Për shkak ndryshimit të strukturës së Shqipërisë, pozicioni i punës, suprimohet”.

Mbështetur në nenin 3, pika 3 e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi ku citohet se: “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”, Komisioneri vlerëson se veprimet e UKT SHA, në dukje janë veprime të paanshme dhe ligjore, por duke vlerësuar pasojat e tyre, është e qartë se këto veprime janë ndërmarrë në mënyrë të qëllimshme, kundër anukeses. Mjetet e përdorura prej tyre, nuk e justifikojnë qëllimin dhe nuk mund ta fsheh faktin e dijenisë së Strukturës Organizative dhe ndryshimeve në të. UKT e ka të qartë se pozicioni “Teknik bilanci” është parashikuar të suprimohet, ndaj gjithë hapat administrativ të ndërmarra prej saj, janë përdorur për të fshehur dhe justifikuar largimin nga puna të ankueses.

Përsa më sipër, mbështetur në nenin 7, pika 1, e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”, Komisioneri vlerëson se veprimet e Drejtorit të Përgjithshëm të UKT SHA e kanë ekspozuar ankuesen ndaj kundrajt trajtimit të padrejtë e të pabarabartë me pasojë diskriminimin.

Lidhur me diskriminimin për shkak të bindjeve politike, të pretenduar nga ankuesja, Komisioneri vëren se,

Ankuesja është anëtare e subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë”⁵; Vëzhguese e këtij subjekti në KZAZ qarku Elbasan në zgjedhjet e vitit 2009; Anëtare e KQV-së Nr. 2337 në zgjedhjet e vitit 2013; Anëtare e këtij subjekti pranë KZAZ Nr. 49 në Elbasan, gjatë zgjedhjeve për pushtetin lokal në vitin 2015.

⁵ Në cilësinë e provës është depozituar fotokopje e kartës së anëtarësimit, Nr.175306082V, datë 28.01.2016



- Në aktin me nr.23675/2 prot, datë 26.11.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të UKT-së, drejtuar Asamblesë së Aksionerëve të UKT-së, me lëndë: “Relacion për miratimin e Projekt-Vendimit “Për ndryshimin e strukturës dhe organigramës së shoqërisë”, citohet shprehimisht se: “...*Nga vëzhgimet e deritanishme rezulton se pjesa dërrmuese e emërimeve të viteve të fundit është bërë në bazë të orientimeve politike, pa vlerësuar kualifikimet që kërkon kjo Kompani. Në këto kushte propozojmë që numri i punonjësve nga 1300 që është miratuar të ulet në 863 punonjës*”.

Nga analizimi i kontekstit të kësaj shkrese, vihet re së pari se UKT SHA ka ka prezumuar punësimin e punonjësve në këtë institucion, mbi bazë të bindjeve politike.

Së dyti, nga sa thuhet në akt “Nga vëzhgimet e deritanishme rezulton se ...”, vet UKT ka bërë një pohim, lidhur me vlerësimin e situatës së punësimit të punonjësve mbi baza politike.

Sa sipër, mbështetur në detyrimet që parashikon neni 82, pika 2 e Kodit të Procedurave Administrative: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”, parashikimet e aktit nr.23675/2 prot, datë 26.11.2015, nuk janë argumentuar as hedhur poshtë me prova nga UKT-ja.

Pra shihet qartë, se ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së punonjësve mbi bazë të bindjeve politike, është një orientim për shkurtrimin e numrit të punonjësve.

Referuar aktit: “Në këto kushte propozojmë që numri i punonjësve nga 1300 që është miratuar të ulet në 863 punonjës”, ankuesja [\[shprehim opinionin e saj\]](#), ka qenë e ekspozuar politikisht për shkak të bindjeve të saj të djathta.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1e ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se ankuesja [\[shprehim opinionin e saj\]](#) është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Strukturave drejtuese të Shoqërisë UKT SHA, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me bindjet e saj politike

Për sa më sipër, në bazë të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka tagër për dhënie dëmshpërblimi moral (financiar), ndaj ankuesja duhet t’i drejtohet gjykatës, për të përfituar këtë dëmshpërblim.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 2 3 pikat 1 dhe 3, nenin 4 pika 1, nenin 7 pika 1, nenet 12, 13 e 15, nenin 21 pika 1, nenin 32 pika 1 gërma a) dhe c), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të znj. *Aurora E...*, nga ana e Shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” SHA, për shkak të “bindjeve politike”.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Shoqërisë së “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” SHA, për rikthimin në punë të znj. *Aurora E...*
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” SHA të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 11 dhe 13 të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të këtij vendimi.

KOMISIONERI

Irma Baraku
IRMA BARAKU

